

VENDIM
Nr. 505, datë 17.7.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE TË
FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26, të ligjit nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Vendimi nr. 672, datë 26.10.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

KREU I
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 1
Objekti i rregullore

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe detyrave të hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (në vijim KKK), kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i Këshillit, procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, procedurat për hartimin e standardeve kontabël kombëtare dhe të produkteve të tjera, të realizuara nga anëtarët e këtij Këshilli ose të tretët.

Neni 2
Objektivat, përgjegjësitë dhe detyrat e KKK-së

1. Objektivat kryesorë të KKK-së janë, si më poshtë vijon:
 - a) përsosja e vazhdueshme e legjislacionit për kontabilitetin;
 - b) përpunimi i sistemit kontabël në përputhje me ligjin për kontabilitetin;
 - c) hartimi dhe përmirësimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit;
 - ç) nxitja e përdorimit dhe zbatimit të standardeve kombëtare të kontabilitetit (SKK) dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF);
 - d) monitorimi i zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar.
2. Në bazë të ligjit për kontabilitetin, KKK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:

- a) Paraqet propozime pranë ministrit përgjegjës për financat, për përgatitjen ose ndryshimin e legjislacionit në fuqi në fushën e kontabilitetit;
 - b) Harton SKK-të, në zbatim të ligjit për kontabilitetin;
 - c) Harton rregulla të tjera dhe rregullore në fushën e kontabilitetit;
 - ç) Jep shpjegime, interpreton dhe përgjithëson problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël kombëtare, në formën e udhëzimeve kontabël;
 - d) Rishikon dhe shpreh opinionet e veta për projektaktet ligjore dhe nënligjore, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin dhe profesionet e lira në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit;
 - dh) Organizon punën për përkthimin e SNRF-ve;
 - e) Jep rekomandime për përgatitjen e specialistëve kontabilistë në institucionet e arsimit të lartë;
 - ë) Vendos dhe mban kontakte me organizma ndërkombëtarë të kontabilitetit (përfshirë Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit IASB, institucione dhe organizma të ndryshëm të Bashkimit Evropian si dhe organe të tjera të hartimit të standardeve në vende të tjera) dhe merr pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare që lidhen me kontabilitetin;
 - f) U krijon mundësi anëtarëve dhe stafit të vet të marrin pjesë në konferenca dhe aktivitete të ndryshme profesionale, në Shqipëri dhe jashtë vendit;
 - g) Publikon në faqen zyrtare të institucionit standardet kombëtare të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;
 - gj) Boton standardet kombëtare të kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;
 - h) Monitoron zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të raportimit financiar;
 - i) Organizon tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës nëpërmjet përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike;
 - j) Raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij;
 - k) Raporti, sipas shkronjës “j”, të këtij neni, ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të shkronjës “j”, të këtij neni;
 - l) Publikon raportin vjetor në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, brenda afatit të përcaktuar në shkronjës “j”, të këtij neni.
3. KKK-ja është e pavarur në hartimin e sistemit kontabël të SKK-ve dhe të rregullimeve të tjera kontabël.

Neni 3

Kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i Këshillit

1. Kërkesat e posaçme që duhet të përmbushë një kandidat për të qenë anëtar i këshillit janë, si më poshtë vijon:
 - a) Të ketë edukim në fushën e kontabilitetit dhe/ose financës;
 - b) Të jetë ekspert në teorinë dhe metodologjinë e kontabilitetit (me titull /gradë) dhe, të paktën, 5 (pesë) vitet e fundit të jetë i përfshirë drejtpërdrejt në këtë fushë; ose praktikues i licencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 10 (dhjetë) vitesh; ose praktikues i palicencuar në fushën e kontabilitetit prej jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh;
 - c) Të ketë figurë të pastër morale dhe autoritet të njohur profesional.

Neni 4

Përfundimi i mandatit të anëtarit të KKK-së

1. Anëtari i KKK-së lirohet nga detyra me përfundimin e afatit 4-vjeçar të mandatit të tij. Ministri përgjegjës për financat nxjerr urdhrin për lirimin e anëtarit të KKK-së që i ka mbaruar mandati.

2. Kryetari i KKK-së, jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të mandatit të anëtarit të KKK-së, njofton organin/et propozues/e të atij anëtari për të sjellë propozimet për anëtarin e ri të KKK-së.

3. Kryetari i KKK-së i paraqet ministrit përgjegjës për financat propozimin/propozimet për anëtarin/anëtarët e ri/rinj të KKK-së, ardhur nga organet propozuese, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a” “b” “c” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 25, të ligjit për kontabilitetin.

Neni 5

Dorëheqja e një anëtari të KKK-së

1. Kur një anëtar i KKK-së vendos të tërhiqet nga detyra, duhet t'i paraqesë kërkesë me shkrim për dorëheqje organizmit që e ka propozuar dhe kryetarit të KKK-së, i cili ia përcjell për miratim ministrit përgjegjës për financat.

2. Ministri përgjegjës për financat, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas njoftimit me shkrim nga KKK-ja për dorëheqjen e anëtarit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxjerr urdhrin për mandatimin e një anëtari të ri. Anëtari i ri propozohet nga të njëjtët organizma që kanë propozuar edhe anëtarin që jep dorëheqjen.

Neni 6

Kryetari dhe nënkryetari i KKK-së

1. Kryetari i KKK-së organizon punën për veprimtaritë e mëposhtme:

a) i jep orientime strukturës administrative për përgatitjen e projektprogramit vjetor të punës së KKK-së;

b) organizon mbledhjet dhe përgatit e materialet e mbledhjes si dhe përcakton kohën dhe miraton projektrendin e ditës së mbledhjes;

c) drejton mbledhjet e KKK-së;

ç) nënshkruan/miraton korrespondencën e KKK-së, përveç sa nënshkruhet nga drejtori ekzekutiv në cilësinë e nëpunësit autorizues.

2. Në mungesë të kryetarit, detyrat e tij kryhen nga nënkryetari i KKK-së (në vijim nënkryetari).

Neni 7

Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarit

1. Kryetari dhe nënkryetari i KKK-së zgjidhen nga vetë anëtarët e tij. Mandati i tyre është 4-vjeçar, me të drejtë rikandidimi.

2. Procedura për zgjedhjen e kryetarit dhe të nënkryetarit zhvillohet në mbledhjen e parë të përbërjes së re të KKK-së ose në mbledhjen e radhës pas caktimit të një anëtari të ri në vend të kryetarit dhe të nënkryetarit.

3. Mbledhja për zgjedhjen e kryetarit dhe të nënkryetarit zhvillohet kur krijohet kuorumi prej të paktën 5 (pesë) anëtarësh.

4. Kryetari zgjidhet para nënkryetarit. Anëtarët e KKK-së nuk kanë të drejtë abstenimi. Votimi për kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit është i fshehtë. Për zhvillimin e mbledhjes dhe rezultatet e votimit mbahet procesverbal. Për realizimin e procesit të votimit ngrihet një komision

prej 3 (tre) anëtarësh të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të cilët nuk konkurrojnë.

5. Para kryerjes së votimit, anëtari që propozohet duhet të pranojë kandidimin e tij për postet e mësipërme.

6. Kur konkurrojnë disa kandidatë, një anëtar i KKK-së voton vetëm për një kandidat. Nëse konkurren vetëm një kandidat, anëtari i KKK-së voton kundër ose pro tij. Kryetar dhe nënkryetar zgjidhet kandidati që fiton, të paktën, 4 (katër) vota të anëtarëve të KKK-së.

7. Kur në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk ka fituar numrin e nevojshëm të votave, në votimin e dytë votohet vetëm për dy prej atyre që kanë marrë shumicën e votave. E njëjta procedurë ndiqet edhe për zgjedhjen e nënkryetarit.

8. Në rast se kryetari ose nënkryetari nuk zgjidhen për shkak se asnjë nga kandidatët nuk marrin numrin e nevojshëm të votave ose nuk është arritur minimumi i nevojshëm i votave, zgjedhjet përsëriten në një mbledhje tjetër. Nëse kryetari dhe nënkryetari nuk arrijnë të zgjidhen as në mbledhjen e dytë, mbledhja tjetër zhvillohet brenda 10 ditësh pune.

9. Kur për arsyet e përmendura në pikën 8, të këtij neni, kryetari ose nënkryetari nuk arrijnë të zgjidhen në 3 (tri) mbledhje radhazi, atëherë kryetari ose nënkryetari caktohen nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 8 **Mbledhja**

1. Vendimet e KKK-së merren në mbledhjet e këtij Këshilli.
2. Mbledhjet, si rregull, realizohen një herë në muaj, por mund të organizohen sa herë që ka çështje të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen.

Neni 9 **Thirrja e mbledhjes**

1. Mbledhjet thirren nga kryetari. Mbledhja e parë pas krijimit të KKK-së organizohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e emërimit të anëtarëve të KKK-së dhe në këtë mbledhje zgjidhen kryetari dhe nënkryetari.
2. Njoftimi për mbledhje u dërgohet anëtarëve të KKK-së nga kryetari, me postë, faks ose postë elektronike, të paktën dhjetë ditë para datës së zhvillimit të saj.
3. Njoftimi për mbledhje përcakton kohën, vendin dhe rendin e ditës, si dhe hollësi të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me të. Njoftimit i bashkëlidhen materialet që kanë të bëjnë me çështjet e rendit të ditës.

Neni 10 **Rendi i ditës së mbledhjes**

1. Të gjithë anëtarët e KKK-së mund të propozojnë çështje të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme, të cilat miratohen nga KKK-ja. Në intervalin e kohës ndërmjet dy mbledhjeve, kryetari ka të drejtën të shtojë çështje shtesë në rendin e ditës pa miratimin e anëtarëve të KKK-së.
2. Në mbledhjen e ardhshme përfshihet në rendin e ditës një pikë/çështje për diskutim, e cila në mbledhjen paraardhëse është miratuar me shumicë të thjeshtë votash. Ndonjë pikë/çështje për diskutim që ka qenë e përfshirë në rendin e ditës të mbledhjes së mëparshme, por për shkak të kohës së kufizuar nuk është arritur të trajtohet, kalon automatikisht për diskutim në rendin e ditës të mbledhjes së pasardhëse.

Neni 11 **Mbledhja dhe marrja e vendimeve**

1. Mbledhjet drejtohen nga kryetari. Në mungesë të tij drejtohen nga nënkryetari. Deri në zgjedhjen e kryetarit, ose në rast se si kryetari ashtu edhe nënkryetari mungojnë, mbledhjet drejtohen nga anëtari më i moshuar i KKK-së.

2. Kuorumi i kërkuar për marrjen e vendimeve në mbledhjet e KKK-së është prania e të paktën 5 (pesë) anëtarëve.

3. Çdo anëtar i KKK-së ka të drejtën e një vote. Anëtarët e KKK-së nuk duhet të abstenojnë në votim. Në rast të votave të barabarta, vota e drejtuesit të mbledhjes është përcaktuese.

4. Standardet kombëtare të kontabilitetit dhe produktet e tjera kontabël, që lidhen me plotësimin e objektivave të KKK-së, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 2, të kësaj rregulloreje, miratohen nga të paktën pesë anëtarë të KKK-së. Çështjet e tjera miratohen me një shumicë të thjeshtë votash të numrit të anëtarëve të KKK-së.

5. Anëtari i KKK-së nuk mund të marrë pjesë në votim kur ka konflikt interesi, siç përcaktohet në Kodin e Etikës, të miratuar nga KKK-ja (deri sa KKK-ja të miratojë kodin e vet do të përdoret Kodi i Etikës i Komitetit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC)). Kur ka konflikt interesi, anëtari njofton drejtuesin e mbledhjes para se çështja përkatëse të diskutohet në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Neni 12

Marrja e një vendimi jashtë mbledhjeve

1. Vendimet e KKK-së mund të merren edhe jashtë mbledhjes. Për marrjen e vendimit në këtë rast, kryetari i KKK-së u përcjell anëtarëve të KKK-së projektvendimin përkatës dhe materialet që lidhen me të dhe cakton një afat jo më pak se 5 (pesë) ditë pune për marrjen e përgjigjeve dhe të reagimeve të anëtarëve.

2. Mënyra e miratimit të projektvendimit përkatës është i njëjtë me atë të parashikuar në pikën 4, të nenit 11, të kësaj rregulloreje. Anëtarët që nuk kthejnë përgjigje brenda afatit të kërkuar do të konsiderohen sikur janë pro vendimit.

3. Rezultatet e votimit pasqyrohen në një procesverbal të posaçëm, sipas nenit 14, të kësaj rregulloreje.

4. Kryetari i KKK-së shpall rezultatet e votimit në mbledhjen e parë, pas afatit të caktuar prej tij për marrjen e përgjigjeve.

Neni 13

Mundësia e pjesëmarrjes në mbledhje

Mbledhjet e KKK-së janë të mbyllura. Përfundimisht, pjesëmarrja e palëve të interesuara ose publikut vendoset nga drejtuesi i mbledhjes, me miratimin e jo të më pak se 5 (pesë) prej anëtarëve.

Neni 14

Mbajtja e procesverbaleve të mbledhjeve

1. Për mbledhjet e KKK-së mbahen procesverbale të veçanta.

2. Procesverbalet pasqyrojnë:

a) numrin, radhën e mbledhjes;

b) datën dhe vendin e mbledhjes, kohën e fillimit e të mbylljes;

c) emrin e drejtuesit dhe sekretarit të mbledhjes;

ç) emrat e anëtarëve të KKK-së të pranishëm, si dhe emrat e personave të tjerë;

d) rendin e ditës;

dh) vendimet e marra dhe rezultatet e votimit;

e) shënime të mendimeve të pakicës, kur kërkohet nga anëtari që është në pakicë;

ë) hollësi të tjera që gjykohen të rëndësishme.

3. Mendimi me shkrim i pakicës së anëtarit të KKK-së paraqitet në sekretari, i nënshkruar menjëherë pas votimit të vendimit me të cilin lidhet mendimi në fjalë, por jo më vonë se ditën pasardhëse të punës.

4. Procesverbalet e mbledhjes nënshkruhen nga kryetari, sekretari dhe nga anëtari i KKK-së që ka shprehur mendimin në pakicë. Kryetari mban përgjegjësi për pasqyrimin e saktë dhe të plotë të vendimit të marrë dhe të rezultateve të votimit.

5. Procesverbalet origjinale të nënshkruara, njoftimi për mbledhje dhe materialet shoqëruese arkivohen në zyrat e KKK-së.

Neni 15

Komisionet e veçanta të përhershme ose të përkohshme

1. Me qëllim që të përmbushë detyrat e veta, KKK-ja mund të ngrejë komisione të posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme.

2. Komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, mund të përfshijnë, përveç anëtarëve të KKK-së, edhe specialistë të tjerë me kontribut të spikatur në fushën e kontabilitetit ose fusha të tjera, por jo më shumë se shtatë anëtarë.

3. Komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, ngrihen kur vendoset nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të KKK-së.

4. Anëtarët e komisioneve të posaçme, të përkohshme apo të përhershme, për realizimin e detyrave të tyre, angazhohen me kohë jo të plotë pune.

5. Komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, ngrihen:

a) për të zhvilluar strategji për veprimtarinë e KKK-së në tërësi ose në fusha të caktuara;

b) për të hartuar një SKK të ri ose për të përmirësuar një SKK ekzistues;

c) për të hartuar rregulla dhe rregullore të tjera në fushën e kontabilitetit dhe profesionet e kontabilitetit;

ç) për të diskutuar problemet dhe për të propozuar zgjidhje, në lidhje me çështje të veçanta të kontabilitetit;

d) për të rishikuar dhe për të shprehur mendimet e tij për projektligje dhe rregullore të ndryshme, të cilat përmbajnë dispozita të veçanta mbi kontabilitetin dhe profesionet e lidhura me të;

dh) për të ndjekur dhe për të rishikuar procesin e përkthimit të SNRF-ve;

e) për çështje të tjera lidhur me misionin e KKK-së.

6. Institucioni i KKK-së ka të drejtë të kontrakttojë të tretët për shërbime të ndryshme, në lidhje me përmbushjen e detyrave të veta, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi në lidhje me prokurimin publik.

7. Rekomandimet dhe dokumentet e tjera të përgatitura nga komisionet e posaçme/të specializuara, të përhershme ose të përkohshme, dhe nga të tretët bëhen efektive kur miratohen nga KKK-ja, sipas rregullave të votimit të përcaktuara në pikën 4, të nenit 11, të kësaj rregulloreje.

KREU II

PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE RASTET E SHKARKIMIT TË ANËTARËVE

Neni 16

Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KKK-së

1. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

a) 1 (një) anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;

b) 1 (një) anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;

c) 1 (një) anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësisve ekonomike të mëdha ose njësisve ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;

ç) 3 (tre) anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;

d) 1 (një) anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit duhet të plotësojnë kriteret specifike të paraqitura në nenin 3, të kësaj rregulloreje.

3. Në rastin e anëtarit që përzgjidhet sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 16, të kësaj rregulloreje, njoftimi për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të KKK-së, mënyra e vlerësimit të kandidatëve bazuar në kriteret e parashikuara në këtë rregullore, vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit caktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

4. Në rastin e anëtarit që përzgjidhet sipas shkronjave “a”, “ç” dhe “d”, të nenit 16, të kësaj rregulloreje, institucionet përkatëse paraqesin drejtpërdrejt kandidaturat pranë ministrisë përgjegjëse për financat. Këto institucione janë përgjegjëse për plotësimin e kriterëve të posaçme, të parashikuara në nenin 3, të kësaj rregulloreje, për kandidaturat e paraqitura për miratim nga ministri përgjegjës për financat.

5. Njoftimi i konkurrimit për anëtar të Këshillit përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Një përshkrim të shkurtër të kompetencave e të funksionit që do të mbulojë anëtari;

b) Kërkesat për pranimin e kandidatëve;

c) Listën e dokumenteve që duhet të paraqiten, vendin ku do të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet;

ç) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen.

Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

6. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Këshillit, sipas pikës 3, të këtij neni, kryhet nga një komision *ad-hoc*, i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore.

7. Kandidatët, që aplikojnë për anëtarë të Këshillit, sipas pikës 3, të këtij neni, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financat dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim;

b) kopje të pasaportës ose të kartës së identitetit (ID);

c) *Curriculum vitae*;

ç) rekomandime që vërtetojnë figurën e pastër morale dhe autoritetin profesional të kandidatit;

d) kopje të noterizuar të librezës së punës;

dh) kopje të noterizuar të diplomës;

e) kopje të noterizuara të dëshmimeve e të certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;

ë) dëshminë e penalitetit.

Dokumentet e përcaktuara në shkronjën “e”, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e shpalljes së njoftimit.

9. Komisioni *ad-hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e nenit 3, të kësaj rregulloreje, të shoqëruar me një relacion përmbledhës, i cili i paraqitet për miratim ministrit përgjegjës për financat.

Në relacion, komisioni i rekomandon ministrit të Financave dhe Ekonomisë emërimin e kandidaturave.

Neni 17

Rastet e shkarkimit të një anëtari

1. Kryetari i KKK-së njofton menjëherë ministrin përgjegjës për financat nëse janë rrethanat e përmendura në pikën 7, të nenit 25, të ligjit për kontabilitetin. Ministri përgjegjës për financat gjykon mbi rrethanat, dhe nëse e çmon të arsyeshme, nxjerr urdhrin për heqjen e mandatit të një anëtari të KKK-së ose njofton kryetarin e KKK-së në rast mospranimi për heqjen e mandatit.

2. Një anëtar i KKK-së konsiderohet se nuk përmbush kërkesat e kësaj rregulloreje dhe mund t'i hiqet mandati kur:

- a) nuk i pranon ose nuk i përmbush detyrimet në KKK;
- b) shkel rëndë Kodin e Etikës profesionale të miratuar nga KKK-ja (deri sa KKK-ja të miratojë një kod të tillë, do të përdoret si bazë “Kodi i Etikës së Kontabilistëve Profesionistë” i IFAC (Komiteti i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve);
- c) nuk merr pjesë në të paktën 50% të mbledhjeve gjatë një viti, pa arsye;
- ç) dënohet me vendim të formës së prerë;
- d) për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara.

3. Në rastin e shkarkimit të një anëtari, ministri përgjegjës për financat nxjerr urdhrin për mandatin e një anëtari të ri, i cili duhet të miratohet jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas marrjes së njoftimit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, sipas procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara në nenin 16, të kësaj rregulloreje.

KREU III

PROCEDURAT PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E STANDARDEVE KOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE PROCEDURAT PËR PËRKTHIMIN E SNRF-ve

Neni 18

Standardet kombëtare të kontabilitetit

1. SKK-të hartohen në koherencë me SNRF-të. Në raste të justifikuara, ato mund të përmbajnë përjashtime nga SNRF-të, zbatime të thjeshtuara ose shmangie nga SNRF-të, për të gjitha ose një pjesë të njësisë ekonomike. Në rast përjashtimesh, SKK-të korresponduese përshkruajnë dhe paraqesin arsyet pse janë të nevojshme.

2. SKK-të u referohen SNRF-ve përkatëse, në bazë të të cilave ato janë përgatitur.

Neni 19

Procedurat për miratimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit

1. Sa herë që IASB-ja nxjerr një SNRF të re ose të ndryshuar, KKK-ja vlerëson nevojën për nxjerrjen e një SKK-je të re ose përmirësimin e një SKK-je ekzistuese.

2. Procedura për miratimin e një standardi kombëtar të kontabilitetit, të ri ose të përmirësuar, përmban hapat, si më poshtë vijon:

- a) miratimin e objekt-përmbajtjes së standardit kombëtar të kontabilitetit, të re ose të përmirësuar;
- b) miratimin e komisionit të posaçëm/specializuar dhe të grupit të punës, ku mund të përfshihen edhe ekspertë jashtë KKK-së;
- c) caktimin e afatit kohor për hartimin e SKK-së;
- ç) projektstandardi kombëtar i kontabilitetit (pika 4, e nenit 11) miratohet kur votohet nga të paktën 5 (pesë) anëtarë të KKK-së;
- d) organizimi i disa tryezave të rrumbullakëta, në një periudhë jo më shumë se 30 (tridhjetë)

ditë për të diskutuar projektstandardin kombëtar të kontabilitetit, të ri ose të përmirësuar, me palët kryesore të interesuara (shoqatat e profesionit, përfaqësues të bankave të nivelit të dytë, përfaqësuesit e organeve tatimore, kompanitë audituese etj.);

dh) publikimi i projektstandardit kombëtar të kontabilitetit në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe dërgimi i tij për komente palëve të tjera të përfshira në këtë proces. Afati për komente është të paktën 3 muaj nga data e publikimit të projektstandardit kombëtar të kontabilitetit. Në rast se gjykohet e nevojshme nga KKK-ja, projektstandardi kombëtar i kontabilitetit publikohet sërish për komente, për një periudhë të re tremujore. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur një rregullim ligjor i caktuar hyn në fuqi përpara afatit të përcaktuar në këtë shkronjë;

e) marrja në shqyrtim e të gjitha komenteve të siguruara sipas shkronjave “d” dhe “dh” dhe reflektimi i atyre komenteve që miratohen te projektstandardi kombëtar i kontabilitetit, i ri ose i përmirësuar;

ë) miratimi në Këshill i SKK-së përfundimtare dhe dërgimi te ministri përgjegjës për financat;

f) shpallja e SKK-së për zbatim nga ministri përgjegjës për financat;

g) publikimi i SKK-së, së re ose të përmirësuar, në Fletoren Zyrtare, faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat dhe në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Neni 20

Procedurat për përkthimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar

1. Në mbështetje të ligjit për kontabilitetin, pikën 4, të nenit 3 të tij, SNRF-të përkthehen në gjuhën shqipe, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze dhe shpallen të detyrueshme për zbatim me urdhër të ministrit përgjegjës për financat. KKK-ja për të siguruar përkthimin e SNRF-ve ngre komitetin e rishikimit (KR) të SNRF-ve të përkthyer, në dispozicion të të cilit vendos logjistikën e nevojshme.

2. Komiteti i rishikimit përbëhet nga dy përkthyes dhe dy ose më shumë rishikues. Komiteti i rishikimit ka mandat dyvjeçar. Zgjedhja e anëtarëve rishikues të komitetit të rishikimit bëhet sipas dokumentit “Procesi zyrtar i rishikimit të përkthimit në gjuhën shqipe të SNRF-ve”, miratuar nga grupi i përkthimit, adoptimit dhe të drejtës së autorit pranë fondacionit të SNRF (*IFRS Foundation*). Anëtarët e komitetit të rishikimit nuk kanë kufizime mandati për t’u rizgjedhur.

3. Procesi i përkthimit është shërbim kundrejt pagesës ndërsa procesi i rishikimit është shërbim pa pagesë. Tarifat e shpërblimit për përkthimin i referohen rregullimeve me aktet nënligjore në fuqi.

4. Staf i administrativ i KKK-së është koordinatori i procesit të përkthimit. Staf i organizon punën, për:

a) përgatitjen e paketave të materialeve për përkthim;

b) shpërndarjen e materialeve të përkthyer tek rishikuesit;

c) përgatitjen mbi baza vjetore të variantit të konsoliduar të SNRF-ve të përkthyer në gjuhën shqipe;

ç) mirëmbajtjen e platformave elektronike të komunikimit në grup me anëtarët e komitetit të rishikimit.

5. Pas miratimit nga KKK-ja, SNRF-të e përkthyer dhe të rishikuara dërgohen te ministri përgjegjës për financat, i cili bën për shpalljen e tyre të detyrueshme për zbatim. Pas shpalljes, ato publikohen në Fletoren Zyrtare, në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat dhe në faqen e internetit të KKK-së.

6. Varianti i konsoliduar i SNRF-ve të përkthyer në gjuhën shqipe, përgatitur nga stafi administrativ i KKK-së publikohet në faqen e internetit të KKK-së.

KREU IV
ÇËSHITJE ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Neni 21

Mbështetja administrative dhe teknike

1. Veprimtaritë e KKK-së mbështeten nga një personel i nevojshëm administrativ e teknik, i cili emërohet nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
2. Për mënyrën e organizimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës administrative hartohet një rregullore e brendshme, e veçantë, e cila miratohet nga KKK-ja.
3. Zyrat, struktura, organika dhe pagat e personelit administrativ miratohen nga Këshilli i Ministrave.